



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 21 dhjetor 2020
Nr. ref.: RK 1667/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI34/19

Parashtrues

Qamil Lupçi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme
ARJ-UZVP. nr. 66/2018, të 5 dhjetorit 2018**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Qamil Lupçi (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës) nga Lupçi i Poshtëm, Komuna e Podujevës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin [ARJ-UZVP. nr. 66/2018] e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), të 5 dhjetorit 2018.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjyimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (në tekstin e mëtejme: KEDNJ), si dhe me nenin 7 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: DUDNJ).
4. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkon nga Gjykata të jetë i pranishëm gjatë seancës së Gjykatës kur të vendoset për kërkesën e tij.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 20 [Vendimet] dhe 22 [Procedimi i kërkesës] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 28 shkurt 2019, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 4 mars 2019, Kryetarja caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
8. Më 12 mars 2019, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Në të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
9. Më 25 nëntor 2020, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 11 dhjetor 2015, parashtruesit të kërkesës, në pajtim me Vendimin [nr. 389, të 7 dhjetorit 2015] e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (në tekstin e

mëtejme: MPMS) i ishte ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së moshës 65 vjeçare, përkatësisht për shkak të shkuarjes në pension.

11. Më 14 janar 2016, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë pranë Komisionit për Ankesa të MPMS-së kundër Vendimit [nr. 389, të 7 dhjetorit 2015] të MPMS-së.
12. Më 22 shkurt 2016, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPMSHCK) kundër Vendimit [nr. 389, të 7 dhjetorit 2015] të MPMS-së, si dhe për shkak të mosmarrjes së një vendimi lidhur me ankesën e tij të 14 janarit 2016, të parashtruar pranë Komisionit për Ankesa të MPMS-së.
13. Më 14 prill 2016, KPMSHCK përmes Aktvendimit nr. A/02/64/2016 e hodhi poshtë ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e la në fuqi Vendimin [nr. 389, të 7 dhjetorit 2015] e MPMS-së. Në arsyetimin e Aktvendimit të KPMSHCK-së, ndër të tjera, thuhet se:

“[...] marrëdhënia e punës e nëpunësit civil përfundon me krijimin e kushteve ose fakteve të parapara me legjislacionin në fuqi”, në paragrafin 2.1. “marrëdhënia e punës e nëpunësit civil përfundon me arritjen e moshës për pensionim”, sepse ankuesit Qamil Lupçit i është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së moshës për pensionim, bazuar në certifikatën e lindjes nr. L. 02007006 të lëshuar nga Komuna e Podujevës.

Në bazë të shkresave të lëndës Paneli konstatoi se mbeten pretendimet ankimore të ankuesit se punëdhënësi nuk e kishte njoftuar atë për pensionimin e tij në pajtim me nenin 91, paragrafi 2 i Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, por kjo mungesë e informacionit nuk shkaktoi pasoja ose dëmtimin e palës ankuese, pasi që edhe ankuesi edhe punëdhënësi gjithashtu e kanë ditur që ankuesi më 7.12.2015. e arrin moshën për pensionim dhe se dispozitat ligjore në kuadër të Shërbimin Civil të Kosovës në lidhje me këtë çështje janë imperativ.

Sa i përket pretendimit ankimor që MPMS ka dorëzuar kopjen e vendimit për pensionim, Paneli vëren se MPMS është e detyruar t'i lëshoj palës ankuese me rastin e pensionimit dokumentin origjinal në numër të mjaftueshëm të kopjeve. [...]”.

14. Më 25 prill 2016, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore), duke kontestuar ligjshmërinë e Aktvendimit [A/02/64/2016] të KPMSHCK-së, si dhe të Vendimit [nr. 389] të MPMS-së, me pretendimin se para se të merrej vendimi për pensionim, MPMS, sipas Ligjit për Shërbimin Civil, ishte e obliguar ta informonte parashtruesin 6 muaj para datës së pensionimit për përmbushjen e kushteve për pension.
15. Më 9 shkurt 2018, Gjykata Themelore në Prishtinë [me Aktgjykimin A. nr. 621/2016] e refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit. Si arsye për refuzimin e kërkesës, Gjykata Themelore, ndër të tjera, theksoi: (i) *sa i përket ligjshmërisë së vendimit të kontestuar me padi, gjykata iu referua dispozitave*

të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, përkatësisht nenit 90 të Ligjit në fjalë, i cili përcakton se marrëdhënia e punës në shërbimin civil përfundon për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, dhe (ii) sa i përket obligimit të MPMS-së, që ta njoftoj parashtruesin për përmbushjen e kushteve për pensionim 6 muaj para pensionimit, edhe pse organi i punësimit nuk e ka informuar paraprakisht paditësin se marrëdhënia e tij e punës është duke përfunduar, kjo mungesë informacioni nuk i shkaktoi ndonjë pasojë apo dëm paditësit dhe në këtë kuptim, në përputhje me vlerësimin e gjykatës, e paditura ka aplikuar në mënyrë të drejtë dispozitat e lartpërmendura të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës.

16. Kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, parashtruesi paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit, për shkak të “vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të ligjit material.”
17. Më 10 tetor 2018, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [AA. nr. 157/2018] e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar dhe e vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore. Gjykata e Apelit e arsyetoi pathemelësinë e ankesës në bazë të faktit se, siç pretendon, Gjykata Themelore me të drejtë e refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit si të pabazuar dhe pa shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore. Më tej, ajo konsideroi se Gjykata Themelore i ka administruar provat dhe faktet në mënyrë të drejtë dhe të plotë dhe po ashtu e ka zbatuar të drejtën materiale në mënyrë të drejtë.
18. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi një kërkesë në Gjykatën Supreme për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të Aktgjykimit [AA. nr. 157/2018] të Gjykatës së Apelit, për shkak se Aktgjykimi në fjalë është i përfshirë me shkelje të së drejtës materiale dhe shkelje të dispozitave procedurale.
19. Me 5 dhjetor 2018, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [ARJ. UZVP. nr. 66/2018] e refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit. Në këtë Aktgjykim, Gjykata Supreme, ndër të tjera, theksoi: “Sipas mendimit të kësaj Gjykate, pretendimet e paditësit se ai nuk ishte njoftuar 6 muaj më herët nga autoriteti përgjegjës për përfundimin e punësimit, janë jorelevante për vendimin e ligjshëm e të paditurit Këshillit të Pavarur për Mbikëqyrje të Shërbimit Civil të Kosovës, pasi që marrëdhënia e punës përfundoi për shkak se paditësi arriti moshën 65 vjeçe dhe marrëdhënia e punës përfundon pavarësisht nga dorëzimi ose mos dorëzimi i njoftimit. Aq më tepër, pasi që me mos dërgimin e njoftimit për përfundimin e marrëdhënies së punës, paditësit nuk i është shkaktuar ndonjë dëm material.”

Dispozitat relevante ligjore

Ligji nr. 03/L-149

PËR SHËRBBIMIN CIVIL TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS (i 13 majit 2010)

[...]

Neni 90
Përfundimi i marrëdhënies së punës

1. Marrëdhënia e punës e nëpunësit civil përfundon me krijimin e kushteve dhe fakteve, pavarësisht nga dëshira e nëpunësit civil ose institucioni.
2. Marrëdhënia e punës në shërbimin civil përfundon me:

2.1. arritjen e moshës së pensionimit;
[...]

Neni 91
Pensionimi

1. Moshë e pensionimit e nëpunësve civilë, si të gjinisë mashkullore ashtu edhe të asaj femërore, është gjashtëdhjetepesë (65) vjeç.
2. Nëpunësi civil informohet për përfundimin e punësimit, gjashtë (6) muaj para datës së pensionimit, nga organi përgjegjës për menaxhimin e personelit të institucionit punëdhënës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta i kanë shkelur të drejtat e tij të mbrojtura me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së si dhe të drejtat e garantuara me nenin 7 të DUDNJ-së, sepse, Vendimi i MPMS-së, nr. 389, i datës 7.12.2015, sipas të cilit ka përfunduar marrëdhënia e punës së parashtruesit të kërkesës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, nuk ka elemente të një akti ligjor sepse nuk i është dorëzuar atij në origjinal.
21. Parashtruesi i kërkesës i arsyeton shkeljet e pretenduara duke theksuar se “Organi i punësimit, MPMS nuk e njoftoi parashtruesin e kërkesës gjashtë muaj përpara datës së daljes në pension, dhe as nuk lëshoi një vendim mbi përfundimin e marrëdhënies së punës për shkak të arritjes së moshës për pensionim. Në këtë rast, organi i punësimit shkeli dispozitën e nenit 91 të ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.”
22. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se neni 91 i Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është aplikuar plotësisht në rastin e parashtruesit të kërkesës.
23. Sipas parashtruesit të kërkesës, si MPMS ashtu edhe parashtruesi i kërkesës u dëmtuan, sepse “parashtruesi u dëmtua sepse nuk u pensionua me dinjitet, ndërsa organi i punësimit u “trimërua” që të jetë në gjendje të veprojë në mënyrë arbitrare dhe të kalojë pa pasoja.”

24. Parashtruesi i kërkesës shprehu dëshirën për të qenë i pranishëm gjatë seancës së Gjykatës kur të vendoset për kërkesën e tij.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

25. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
26. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

„1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shterur të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.“

27. Gjykata më tej i referohet neneve 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

28. Sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, e cila konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [ARJ. UZVP. nr. 66/2018] e Gjykatës Supreme, të 5 dhjetorit 2018, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj si dhe e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar me ligj.
29. Megjithatë, përveç këtyre kriterëve, Gjykata po ashtu duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Konkretisht, rregulli 39 (2) përcakton se:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtuesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

30. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtuesi i kërkesës pretendon shkelje të të drejtave të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si dhe të drejtave të garantuara me nenin 7 të DUDNJ-së, të drejta këto të cilat, sipas parashtuesit të kërkesës, janë shkelur sepse gjykatat e rregullta e kanë interpretuar në mënyrë të gabuar ligjin, përkatësisht të drejtën materiale dhe nuk i janë referuar në mënyrë të duhur Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës.
31. Në dritën e kësaj, Gjykata vëren se parashtuesi i kërkesës përsërit të njëjtat pretendime që i kishte paraqitur para gjykatave të rregullta, të cilat, në thelb, kanë të bëjnë me interpretimin e dispozitave përkatëse të së drejtës materiale (përkatësisht nenit 91 paragrafi 2 të Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës) nga Gjykata Supreme.
32. Gjykata thekson qëndrimin e saj të përgjithshëm se vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike, si dhe interpretimet përkatëse juridike, në thelb, hyjnë brenda juridiksionit të gjykatave të rregullta. Roli i Gjykatës Kushtetuese është që të sigurojë respektimin e standardeve dhe të drejtave të garantuara me Kushtetutë, dhe, rrjedhimisht, ajo nuk mund të veprojë si gjykatë “e shkallës së katërt” (shih, në lidhje me doktrinën e “shkallës të katërt”, rastin e GJEDNJ-së, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, [DHM], nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28).
33. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se interpretimi i së drejtës materiale dhe procedurale është detyrë parësore dhe bie brenda juridiksionit të gjykatave të rregullta (çështje e ligjshmërisë). Roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm të përcaktojë nëse efektet e interpretimit të tillë janë në përputhje me normativat dhe standardet kushtetuese.
34. Në këtë rast konkret, Gjykata vëren se Gjykata Supreme ka dhënë arsye të qarta dhe të mjaftueshme për gjetjet dhe konkluzionet e saj. Kështu, Gjykata Supreme shpjegoi zbatimin e dispozitave përkatëse të Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës në rastin e parashtuesit të kërkesës, duke theksuar se: *“Neni 90, paragrafi 1 i Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës të Kosovës, dhe sipas mendimit të kësaj gjykate, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka vepruar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme me rastin e marrjes së vendimit të saj nr. 389 të datës 7.12.2015 mbi përfundimin marrëdhënies së punësimit për shkak të arritjes së moshës 65 vjeçe. Nga kjo që u tha më sipër, dhe sipas mendimit të kësaj Gjykate, gjykatat e instancave më të ulëta kanë vepruar drejtë kur refuzuan kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, me të cilën kishte kërkuar anulimin e vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës nr. A/02/64/2016 të datës 14.04.2016, pasi që vendimi është lëshuar në bazë të nenit 90, paragrafi 1; nenit 90, paragrafi 1, pika 2.1 dhe nenit 91 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.”*

35. Prandaj, Gjkata vëren se Gjkata Supreme ka konstatuar se, në përputhje me legjislacionin në fuqi, pretendimet e parashtruesit të kërkesës (lidhur me mosinformimin e parashtruesit të kërkesës gjashtë muaj përpara për datën e pensionimit dhe rrjedhimisht për pensionimin e tij të padenjë) nuk kanë ndikim në faktin se nëpunësve civil të cilët e arrijnë moshën 65 vjeçare u përfundon marrëdhënia e punës pavarësisht nga dëshira e nëpunësit civil ose institucionit.
36. Gjkata vëren se parashtruesi i kërkesës deklaroi se Gjkata Supreme nuk e kishte marrë parasysh nenin 91, paragrafi 2 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Gjkata konsideron se në dritën e dispozitave përkatëse për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (të cituara më lart), nuk mund të argumentohet se ka pasur interpretime arbitrare ligjore nga Gjkata Supreme.
37. Si rezultat, Gjkata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet se procedurat përkatëse në ndonjë mënyrë ishin të padrejta apo arbitrare dhe se me vendimin e kontestuar janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë, me KEDNJ dhe me DUDNJ.
38. Si përfundim, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe, rrjedhimisht, e papranueshme.

Kërkesa për seancë dëgjimore publike

39. Gjkata rikujton se parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjkata që të mbajë një seancë dëgjimore.
40. Në këtë drejtim, Gjkata i referohet nenit 20 të Ligjit:

“1. Gjkata Kushtetuese vendosë mbi çështjen pas mbarimit të seancës së shqyrtimit verbal. Palët kanë të drejtë të heqin dorë nga shqyrtimi verbal.

2. Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, sipas vlerësimit të saj, gjykata mund të vendosë mbi çështjen që është objekt shqyrtimi kushtetues mbi bazën e shkresave të lëndës.”

41. Gjkata vëren se nuk ka arsye në të cilat është thirrur parashtruesi i kërkesës e të cilat e mbështesin këtë kërkesë.
42. Gjkata konsideron se dokumentet e përfshira në kërkesë janë të mjaftueshme për të vendosur për këtë rast në përputhje me formulimin e nenit 20, paragrafi 2 të Ligjit (shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI34/17, parashtruese e kërkesës: *Valdete Daka*, Aktgjykim i 12 qershorit 2017, paragrafët 108-110).
43. Prandaj, kërkesa e parashtruesit për mbajtjen e seancës dëgjimore verbale refuzohet si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 dhe 48 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, më 25 nëntor 2020, njëzëri votash

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TË REFUZOJË kërkesën për seancë dëgjimore publike;
- III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- IV. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Selvetë Gërxhallin-Krasniqi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi